

# KULTURA 2023



Nr.19

BULETINI MUJOR / KORRIK

kultura.gov.al



## RESTAUROHET QENDRA "SOTIR KOLEA" NË TIRANË, I RIKTHEHET PUBLIKUT

E mbuluar nga pluhuri i kohës, e shndërruar thuasje në një depo librash të ndaluar, konfiskuar intelektualëve të dënuar gjatë diktaturës, hapësira e njohur si ish-Aneksi i Bibliotekës Kombëtare, sot Qendra "Sotir Kolea" iu rikthye publikut. Bashkë me kryeministrin Edi Rama, drejtorin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë Piro Misha, përfaqësues të trupave diplomatike në Tiranë dhe institucioneve të kulturës, shkencës e arsimit, ministrja e Kulturës Elva Margariti prezantoi këtë hapësirë dedikuar librit, e cila është rikonstruktuar dhe kthyer në jetë falë investimit të qeverisë shqiptare dhe pajisjes me aparatura moderne me mbështetjen e Bashkimit Europian përmes programit Eu4culture. Qendra është organizuar në salla sipas gjuhëve të ndryshme, si franceze, gjermane, italiane, orientale, ruse, por edhe salla "Herbert", "Lumo Skëndo" etj. Projekti konsistoi në rikonstruksionin total të objektit, në krijimin e kushteve dhe hapësirave të përshtatshme të

QENDRA ËSHTË ORGANIZUAR NË SALLA SIPAS GJUHËVE TË NDRYSHME, SI FRANCEZE, GJERMANE, ITALIANE, ORIENTALE, RUSE, POR EDHE SALLA "HERBERT", "LUMO SKËNDO" ETJ.

punës për stafin dhe përdoruesin e rregullt. Punimet e kryera përfshinë rikonstruksionin e hollit të hyrjes, tri salla në katin përdhe, mobilimin me rafte në katin përdhe dhe të parë, lyerjen e hapësirave, punime riparimi të dyshemesë dhe tavaneve, restaurimin e fasadës, punime elektrike, mekanike. Janë kryer punime për mbrojtjen ndaj zjarrit, sistemi i fikjes dhe dedektimit; sistemi i alarmit kundër vjedhjes; riparim i konstruksionit të çatisë. Të gjitha punimet e ndara në tri faza kanë kushtuar rreth 81 milionë lekë. Rijetësimin të kësaj qendre iu bashkua edhe programi EU4Culture i financuar nga BE, zbatuar nga UNOPS Albania, për pajisjen e Njësisë së Restaurimit të Fondit të Bibliotekës Kombëtare Shqiptare me pajisje moderne restauruese, me vlerë mbi 621 mijë euro. Bëhet fjalë për serverë, skanues librash dhe barkodesh, laptopë, tablete, dhoma të pastrimit të lagështirës, makina të pastrimit dhe deacidifikimit të librave etj.



## NIS NGA PUNA QENDRA RAJONALE PËR KONSERVIM DHE RESTAURIM

Me vendim të Këshillit të Ministrave do të nisë funksionimin Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim (QRKR). Kjo qendër, e cila do të marrë jetë pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, vjen jo vetëm si një hap në reformën institucionale që ka përfshirë të gjitha institucionet tona, por mbi të gjitha për të forcuar traditën e formimit të vazhduar; përditësimin e njohurive të restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore; hartimin dhe zbatimin e programeve të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale. QRKR-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Shqipërisë.




## VERA KULTURORE/ MINISTRIA E KULTURËS, DHJETËRA AKTIVITETE

Korriku shënoi kulminacione kulturore dhe artistike. Koncerte të mëdha, net poetike, ekspozita, balet, teatër, mbështetur nga Ministria e Kulturës janë zhvilluar jo vetëm në Tiranë, por edhe në qytetet me një numër të lartë pushuesish. Mund të përmendim një nga aktivitetet më të bukura "Timo Flokko dhe yjet në Butrint", që ngjiti në skenën antike yje të muzikës dhe skenës së teatrit. Nën frymëzimin e vargjeve të Flokos dhe me regji të Vera Grabockës interpretuan Saimir Pirgu, Luiza Xhuvani, Ema Andrea, Rovena Dilo, Piro Çako, Kristian Koroveshi, Arilena Ara, Soni Malaj etj. Një mbrëmje e mrekullueshme "Medalioni i hënës" realizuar nga regjisorja Driada Dervishi, ku copëza nga vepra e Ismail Kadarese u interpretuan nga Yllka Mujo, Ndriçim Xhepa, Vikena Kamenica, Olt Daku, Arben Derhemi etj.

## SHPËTON ISH-RADIO "TIRANA", MIRATOHET PROJEKTI I RESTAURIMIT

Shpëtohet ish-Radio Tirana. Në një nga mbledhjen e muajit korrik Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale miratoi projektin për restaurimin e këtij objekti, monument kulture i kategorisë II. E ndërtuar midis viteve 1928-1930, ndërtesa e dikurshme e Radio Tiranës dhe më pas e Institutit të Kulturës Popullore është një nga vilat e para moderne në qytet. Aktualisht ajo paraqet dëmtime të shumta në çati, fasadë, dysheme, dyer, dritare, në elemente të brendshme e të jashtme. Ndërhyrjet e miratuara në KKTKM, janë sipas ligjit 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" dhe në respekt të statusit të monumentit. Ato konsistojnë në restaurime të çatisë dhe dyshemesë, fasadës, vendosjen e dyerve dhe dritareve të reja, restaurimin e kapiteleve, pastrimin dhe lyerjen e kangjellave, plotësimin me sistem hidraulik e elektrik, sistemimin e oborrit të jashtëm etj. Fillimet e Radio Tiranës datojnë në 28 nëntor 1938. Radiostacioni i parë shqiptar u hap nga Mbreti Zog I dhe Mbretëresha Geraldinë. Vazhdoi të transmetonte edhe gjatë pushtimit italian, por gjatë pushtimit gjerman, në 17 nëntor 1943, radioja ra në duart e pushtuesve. Në vitin 1948, periudhë e aleancës politike me Bashkimin Sovjetik, e gjithë vila u sekuestrua nga Bashkia e Tiranës.



## SHPALLET LISTA E FITUESVE, 57 PROJEKTE PËRFITOJNË NGA BONUSI I RIJETËSIMIT

57 janë përfituesit e Thirrjes së dytë të Bonusit të Rijetësimin. Edhe këtë vit Ministria e Kulturës hapi Thirrjen për Bonusin e Rijetësimin, një nismë e qeverisë shqiptare që synon restaurimin dhe rijetësimin e objekteve monumente kulturore, por edhe ato që nuk mbajnë këtë status, por gjenden në qendra historike e arkeologjike, lagje-kala etj. Buxheti për Bonusin e Rijetësimin është 50% më i madh se një vit më parë dhe harta gjeografike e projekteve fituese është më e gjerë, duke prekur edhe ato zona ku nuk kishte shkuar në vitin 2022, si në Elbasan, Kukës, Bulqizë, Konispol, Qeparo e Himarë, ndërkohë që numri më i madh i përfituesve numërohet në qytetet nën mbrojtjen e UNESCO-s, si Gjirokastra, Berati apo qytetet me trashëgimi kulturore të spikatur si Kruja.

**50% MË I MADH SE NJËVIT MË PARË ËSHTË BUXHETI PËR BONUSIN E RIJETËSIMIT. HARTA GJEOGRAFIKE E PROJEKTEVE FITUESE ËSHTË MË E GJERË, DUKE PREKUR EDHE ATO ZONA KU NUK KISHTË SHKUAR NË VITIN 2022**

## ZBULOHET NJË VENDBANIM RRETH 7900-VJEÇAR NË ZONËN E LINIT

Rezultate mbresëlënëse dhe shumë të rëndësishme për vendbanimet prehistorike në vendin tonë vijnë nga Lini, ku një staf shqiptaro-zviceran, drejtuar nga arkeologët Adrian Anastasi dhe Albert Hafner po zhvillojnë një ekspeditë kërkimore arkeologjike. Sipas raportit të hartuar nga Anastasi e Hafner materialet



organike drusore të zbuluara në sitet nënujore ose të mbuluara me sediment në liqenin e Ohrit apo në bregun e liqenit dëshmojnë për një vendbanim të hershëm fermerësh, që daton rreth 5900-5800 para Krishtit. Analizat me metodën e radiokarbonit po kryhen në Laboratorin C14 në Universitetin e

Bernës, që është një nga partnerët në këto kërkime, së bashku me Institutin e Arkeologjisë, financuar nga Bashkimi Europian.